



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 811/17
Datë/Datum. 01.11.17
PRISHTINË - PRISTINA

PSH. Nr. 811/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, në përbërje prej: z. Goran Milenković - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, si dhe duke u bazuar në nenin 99 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës dhe konform nenit 36 të Rregullores së punës së OSHP-së nr.01/2017, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga autoriteti kontraktues (AK) “Korporata Energjetike e Kosovës”, për diskualifikim nga pjesëmarrja në prokurimin publik të Operatorit Ekonomik: “Xani Inex” nga Prishtina, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Dozator Rotativ”, me numër të prokurimit: “17/189/121”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - / Korporata Energjetike e Kosovës /, më: 26.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet, si e pa bazuar, kërkesa e Autoritetit Kontraktues (AK) - “Korporata Energjetike e Kosovës”, për diskualifikim nga pjesëmarrja në prokurimin publik të OE “Xani Inex”- Prishtinë lidhur me procedurën e prokurimit me titull “Dozator Rotativ”, me numër të prokurimit: “17/189/121”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) / Korporata Energjetike e Kosovës /.

ARSYETIM

Autoriteti Kontraktues / Korporata Energjetike e Kosovës / me dt: 21.09.2017, ka parashtruar kërkesë në OSHP, që të shqyrtohen mundësit e veprimit konform nenit 99 të LPP-së, për diskualifikim të OE “Xani Inex” nga Prishtina.

Përkitazi me kërkesën e AK-së për diskualifikim nga pjesëmarrja në prokurimin publik të operatorit ekonomik “Xani Inex”- Prishtinë, eksperti shqyrtues ka përgatitur një kronologji të cilën ia ka dorëzuar panelit shqyrtues me dt:02.10.2017.

Lidhur me kërkesën e lartpërmendur OSHP-ja ka mbajtur seancën dëgjimore me dt: 26.10.201, ku kanë marr pjesë paneli shqyrtues, përfaqësuesi i AK-së dhe i OE, eksperti shqyrtues i OSHP-së dhe vëzhgues nga OJQ D Plus.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK – KEK z.Emërllahu deklaroi: “Komisioni vlerësues gjatë vlerësimit ka dyshuar se certifikata e OE është e manipuluar, dyshimet kanë qenë pasi që kualiteti i shkronjave ku është cekur validiteti i certifikatës është shumë më kualitativ se pjesa tjetër e shkronjave. Gjithashtu edhe startimi i validitetit të ofertës ka qenë me 26.04.2015. Komisioni ka dashtë të vërtetojë këtë certifikatë dhe i ka bërë pyetje sqaruese ku ka kërkuar të na dërgoj linkun ku është i publikuar kjo certifikatë. OE Xani Inex na është përgjigjur me 07.06.2017. në dokument ka bashkangjitur një Link, dhe një certifikatë të lëshuar nga SINCERT. Ku në certifikatë ceket se prodhuesi Micro Tehnika d.o.o mund të certifikohet. Kjo certifikatë është lëshuar në Maj 2017, që sipas certifikatës paraprake me nr.RS-Q-0859-IIIR, ka qenë e certifikuar. D.m.th brenda kësaj periudhë prapë certifikohet. Nga kjo ka vlerësuar se OE Xani Inex nuk na ka dëshmuar se certifikatë e cila ka qenë në ofertë është valide”.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE “Xani Inex” z.Hajdini deklaroi: “Ne me AK-KEK kemi mbi 500 tender që kemi marr pjesë, kemi mbi 120 kontrata të nënshkruara dhe të realizuara. Deri sot asnjë vërejtje, pyetje përgjigje në punën tonë prej KEK nuk kemi pas, e as nga prodhues apo palë tjetër. Me përfaqësuesin e AK-KEK që është në seancë që tri herë kam problem me komunikim.”

viteve firma e drejtorit të tij dy dit më ka thirre në zyre duke thënë se tenderi rregullohet po çka ka për mua. Kur kam shkuar te drejtori i tij i kam thënë se ju me keni eliminuar për mungesë garancioni, mirëpo un i kam thënë se kemi dhe mund ta hapim kopjen. Kur kemi kërkuar të hapet kopja më kanë lutur që të mos e bëjmë pasi do të ketë probleme me polici. Dallimi mes meje dhe kësaj firme që ka fituar tenderin është 300.000 € më e lartë dhe nuk ka fuqi që mund të merr tenderin në këto raste. Në këtë rast, AK ka kërkuar link, dhe ne kemi ofruar link për dokumentacionin që kemi pas në ofertë. Ne kemi ofruar linkun ashtu si na ka ofruar prodhuesi neve. Në shkresë tjetër sa i përket eliminimit, është se nuk kemi sigurimin e tenderit. Në arsyetim thotë nëse në përgjigjen tuaj në dokumentin e prezantuar 077/2017 as me dokumentin e bashkangjitur e as me linkun nuk keni argumentuar se certifikata e prodhuesit është valide. Këtu qëndron anomalia, pasi AK-ja në arsye të eliminimit thotë se nuk kemi sigurim tenderit ndërsa më pastaj jep arsye tjetër. Me ftesë të AK-së kam shkuar në AK dhe kanë kërkuar se ju si kompani a keni bërë korrektim të ISO certifikatës. Ne i kemi sqaruar AK-së ne kemi prodhues nga vende të ndryshme dhe për dokumente të huaja të kompanive tjera nuk mund të garantojmë dhe mund të garantojmë vetëm për dokumente që mbajnë emrin Xani Inex. Dhe se për dokumentin në fjalë mund të ju garantoj se asnjë pikë apo presje nuk kam shtuar apo hequr. Qëndroj pranë fjalës se kurrë në jetë nuk mund të bëjë një veprim të tillë për cilin pretendon AK-ja. Po ashtu, AK mund të dyshoj, mirëpo nuk ka autoritet të konstatoj se një dokument është i falsifikuar dhe ka institucione përkatëse që mund të konstatojnë një gjë të tillë”.

Gjatë prezantimit në seancë ekspertit shqyrtues z.Sheqiri deklaroi: “AK-ja ka dhënë një konstatim se certifikata në fjalë është e falsifikuar, mirëpo në kërkesë nuk ka dhënë ndonjë argument konkret pasi kjo duhet të konstatohet nga organe përgjegjëse. Mund të ketë dyshime AK-ja mirëpo nuk ka verifikime apo konstatime. Iso Standardi i kërkuar me sa kuptoj unë nuk ka të bëjë direkt me produktin dhe është standard për Sistem për menaxhimin e cilësisë. Mendimi im personal është që për ti thënë është dokumenti i falsifikuar duhet të ketë dëshmi. Komisioni ka ngritur dyshim dhe dyshimi duhet të vërtetohet”.

Kryetari i panelit shqyrtues pyeti përfaqësuesin e AK-së se a keni bërë kërkesë, a i jeni drejtuar me shkrim lëshuesit të kësaj certifikate për të vërtetuar se a e kanë lëshuar të njëjtit këtë certifikatë ?.

Në përgjigje z.Emërllahu deklaroi: “Jo nuk kemi kërkuar direkt nga lëshuesi, mirëpo në faqe të lëshuesit të certifikatës përmes numrit të certifikatës gjendet lehtë certifikata mirëpo komisioni nuk ka arritur përmes certifikatës të gjej certifikatën”.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së, z.Emërllahu deklaroi: “Në njoftim për eliminim ka ndodh një lëshim nga AK në arsyetim rreth sigurisë së tenderit. Pronari i Xani Inex na akuzon se me ndonjë lëndë tjetër ka pas konteste, kërkoj nga z.Hajdini të ofroj argumente për këto akuza përndryshe do të ngreh padi ndaj të njëjtit.

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të kërkesës së autoritetit kontraktues dhe arsyeshmërisë së dhënë, deklaramit te palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, konstaton se autoriteti kontraktues në asnjë mënyrë dhe në asnjë formë nuk ka mundur të dëshmojë se certifikata ISO 9001:2008 e prodhuesit MikroTeknika me nr.RS-Q-0859 e lëshuar nga trupa certifikuese IQNET është e falsifikuar.

Paneli shqyrtues në mungesë të dëshmive dhe argumenteve që certifikata e lartpërmendur është e falsifikuar vjen në përfundim se kërkesa e AK-së, për diskualifikim nga pjesëmarrja në prokurimin elektronik të operatorit ekonomik “Xani Inex”- Prishtinë është e pabazuar dhe e paqëndrueshme.

Prandaj Paneli shqyrtues, duke u mbështetur në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t’i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .



Vendimi t’i dorëzohet:

1x1 AK - “Korporata Energjetike e Kosovës”

1x1 OE - “Xani Inex”- Prishtinë

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ëeb- faqe të OSHP-së.